



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 634 Prot.

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M

Nr.224, datë 30.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konfirmimit si “nëpunës civil”, në përfundim të periudhës së provës për nëpunësin civil *** , dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 634 prot., datë 16.07.2020, nëpunësi ***** ka ngritur pretendimin për parregullsi të kryera ose të lejuara nga Bashkia Berat, për moszbatim të legjislacionit për shërbimin civil në lidhje me konfirmimin e nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës, duke kërkuar për këtë, ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rregullimin e ligjshmërisë.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u kërkuua dokumentacioni përkatës nga njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Berat, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se, kërkuesi ***** , pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në datën 01.10.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist i kontrollit të Investimeve

të Punëve Publike dhe Private”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në Bashkinë Berat.

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se nëpunësi ***** , krahas plotësimit të detyrave të ndryshme të ngarkuara nga eprori direkt, ka ndjekur programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA, gjatë periudhës 23 Prill – 8 Maj 2019 të cilën e ka përfunduar me sukses, duke u pajisur me certifikatën përkatëse, nga ku rezulton të jetë vlerësuar me 20 pikë.

Pas përfundimit të periudhës një vjeçare të provës, në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, aftësive dhe dobësive të nëpunësit për kryerjen e detyrave, për nëpunësin ***** , bazuar në përcaktimet e nenit 24, pika 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreut VI, pika 6, germa b), të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Kreut II, pika 1, germa b), të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, eprori direkt në datën 09.10.2019, ka kryer vlerësimin në punë të nëpunësit në fjalë, për periudhën, 01.10.2018 – 30.09.2019, me nivelin 3 “Kënaqshëm”, rezultat të cilin nëpunësi e ka pranuar.

Më tej, bazuar në detyrimin e përcaktuar në nenin 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësi është paraqitur pranë njesisë përgjegjëse të Bashkisë Berat, dhe ka kërkuar vendimin e konfirmimit si “nëpunës civil”, por ka ardhur në dijeni të faktit se në lidhje me këtë moment nuk është nxjerrë asnjë akt administrativ.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, nëpunësi ***** , nëpërmjet shkresës nr. 1471 prot., datë 11.03.2020, i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë, duke kërkuar informacion në lidhje me arsyet e mos nxjerrjes së aktit për konfirmimin e nëpunësit civil, për të cilën rezulton të mos ketë marrë përgjigje deri në momentin e depozitimit të ankesës pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Duke analizuar në tërësi praktikën shkresore, arrihet në konkluzionin se, institucioni i Bashkisë Berat dhe personat e ngarkuar nga ligji me finalizimin e periudhës së provës, nuk kanë vepruar deri në fund, në përputhje me përcaktimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikave 12 e 13, të vendimit nr. 243 dt. 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Në përmbajtjen e dispozitave të mësipërme, nëpunësi civil në periudhë prove është i detyruar të plotësojë kërkesat e procesit të punës, të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit e ka vendosur eprori direkt. Nga ana tjetër, finalizimi i kësaj procedure bazohet në vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës, proces i cili realizohet nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues, sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit

të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe materializohet me nxjerrjen e vendimit të eprorit direkt për konfirmimin/ose mos konfirmimin e nëpunësit civil, shoqëruar kjo me aktin e deklarimit të statusit, nga njësia përgjegjëse.

Siç u tha dhe më lart, eprori direkt i nëpunësit ***** , Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në datën 09.10.2019, ka plotësuar kërkesën e pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe në bazë të pikës 7/a, të Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, e ka vlerësuar nëpunësin në fjalë, në nivelin 3, “kënaqshëm”.

Në rastin konkret, ndonëse nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Berat, nuk është vepruar, për nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit, siç kërkon pika 13, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, përderisa nuk ka ndonjë akt, apo shkak tjetër të ligjshëm, që të pengojë ose ndërpresë procesin e konfirmimit, për gjithë periudhën pas datës 09.10.2019, kur është bërë vlerësimi nga ana e eprorit direkt dhe në vazhdim, nëpunësi ***** , duhet të konsiderohet nëpunës civil i konfirmuar.

Procesi i mësipërm nga pikëpamja formale, duhet të përmbillet me nxjerrjen e një akti nga ana e eprorit direkt i cili njofton njësinë përgjegjëse për përfundimin e periudhës së provës dhe vlerësimin pozitiv në fund të saj, për nëpunësin ***** dhe mbi këtë bazë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat të nxjerrë aktin përkatës të konfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Berat, si organi kompetent për administrimin e shërbimit civil, duhet të orientojë dhe ndjekë procesin e konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, për nëpunësin civil ***** , duke u kryer veprimet e mëposhtme:
2. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Monitorimit të Investimeve dhe Lejeve, në cilësinë e eprorit direkt, duhet të nxjerrë aktin e njoftimit të njësisë përgjegjëse, në lidhje

me përfundimin e periudhës së provës prej nëpunësit ***** , përfundimin me sukses të trajnimit në ASPA dhe vlerësimin pozitiv të tij, në fund të periudhës së provës.

3. Pas marrjes së njoftimit të mësipërm nga ana e eprorit direkt, njësia përgjegjëse e Bashkisë Berat të veprojë me nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil ***** , duke filluar nga data 09.10.2019.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Berat dhe nëpunësi ***** .
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha